



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 154 / Prot.
11

Tiranë, më 31.01. 2019

VENDIM

“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”

Nr. 5, datë 31.01.2019

Në zbatim të neneve 8 dhe 39 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, të nenit 57 të rregullores “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit” dhe të nenit 10 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

VENDOSI:

1. Të bëhen ndryshime në nenin 18, pika 1, në nenin 24, pika 1, pika 3 dhe pika 4, pika 5; në nenin 25, pika 1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”.
2. Të bëhen ndryshime në nenin 38 pika 3 dhe 4 të rregullores “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”
3. Të bëhen ndryshime në nenin 3 pika 4 të rregullores së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMTARINË
E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE”,**

Në mbështetje të neneve 8 dhe 39 të rregullores “ Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 18, pika 1, shprehja “brenda 5 ditëve” bëhet “brenda 10 ditëve”.

Neni 2

Në nenin 24 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Në pikën 1, shprehja “afati 30-ditor” bëhet “afati 60-ditor”.

Në pikën 3, pas fjalës “gjkues”, shtohet shprehja “nëpërmjet shortit”.

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“Gjyqtari i cili arsyeton vendimin, u përcjell anëtarëve të tjerë të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes projektin e arsytimit të vendimit të dhënë, si rregull brenda 20 ditëve nga shpallja e tij. Secili prej anëtarëve të trupit gjykues mund të japë komentet dhe propozimet e tij me shkrim brenda 15 ditëve, duke i përfshirë në një dokument të përbashkët për të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Komentet dhe propozimet pasqyrohen në projektin e propozuar nga relatori, sipas radhës së votimit. Pas shqyrtimit të komenteve dhe propozimeve, gjyqtari relator jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të afatit të arsytimit të vendimit u shpërndan anëtarëve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar projektin e tij përfundimtar. Trupi gjykues, nën drejtimin e Kryesuesit shqyrton dhe miraton versionin përfundimtar të vendimit. Teksti përfundimtar u dorëzohet gjyqtarëve për nënshkrim.”

Pika 5 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 25, pika 1, shprehja “brenda 30 ditëve” bëhet “brenda 60 ditëve”.